



100 Vjet Pavarësi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

*Projekt  
23/10/2012*

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR  
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE PESHKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetues, të nenit 11, pikës 3 të nenit 51 dhe 56 të ligjit nr. 10433, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 62 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, si dhe neneve ..... të ligjit....., datë..... “Për disa shtesa dhe ndryshime në legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

**I. KRIJIMI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE PESHKIMIT**

1. Krijohet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit (këtëj e tutje në tekstin e këtij vendimi “ISHMPUP”), si institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për mjedisin, pyjet, ujërat dhe peshkimin.
2. Ministria përgjegjëse mbështet funksionimin efektiv të “ISHMPUP”. Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë së inspektimit.

## **II. MISIONI DHE FUNKSIONET E ISHMPUP**

3. ISHMPUP ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit.
4. ISHMPUP është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën ministrore të përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për mjedisin, ujërat, pyjet dhe peshkimin.
5. Përveç sa parashikohet në paragrafin 3 të këtij vendimi, ISHMPUP është përgjegjës për çdo funksion apo kompetence tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e mjedisit.
6. ISHMPUP ushtron juridiksionin e tij territorial në të gjithë territorin e vendit.

## **III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ISHMPUP**

7. ISHMPUP organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal ku këto të fundit janë për çdo qark të vendit.

8. ISHMPUP drejtohet nga Kryeinspektori. Kryeinspektori është titullari i institucionit.

Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të ISHMPUP, Kryeinspektori i ISHMPUP-së ushtron kompetencat si më poshtë:

- a) Përfaqëson ISHMPUP në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHMPUP-së;
- b) Emëron dhe liron nga detyra personelin e ISHMPUP-së dhe të degëve rajonale, në varësi të tij, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi;
- c) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të ISHMPUP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit përgjegjës;
- ç) Nxjerr urdhra dhe udhëzime për mbarëvajtjen e vazhdueshme të punës, për përcaktimin e procedurave, kompetencave, detyrave, dhe funksioneve për kryerjen e veprimtarive inspektuese të strukturave të ISHMPUP-së, në nivel qendror dhe rajonal, në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit;
- d) Bashkërendon veprimtarinë e ISHMPUP-së me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit;
- dh) Siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit, si dhe veprimtari të tjera, për plotësimin e detyrave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimin në këtë fushë;

- e) Siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit;
- ë) Ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.
- 9.** Kryeinspektori i ISHMPUP i raporton drejtpërdrejtë ministrit përgjegjës për mjedisin, pyjet, ujërat dhe peshkimin, përveçse kur ministri ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi në aparatën e ministrisë përgjegjëse.
- 10.** ISHMPUP në nivel qendror ka këto funksione:
- a) planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit;
  - b) siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi;
  - c) bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve të veta dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të tjerë të akredituar, në rastin e pamundësisë së kryerjes së tyre nga laboratorët e veta;
  - ç) informon publikun për veprimtarinë e inspektimit;
  - d) jep mbështetje teknike, administrative dhe shkencore, për veprimtarinë e inspektimit;
  - dh) përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit.
- 11.** Përveç sa parashikohet në paragrafin 8 të këtij vendimi, ISHMPUP në nivel qendror është përgjegjës për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme, për te gjithë institucionin duke përfshirë edhe degët në nivel rajonal:
- a) menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse;
  - b) përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.
- 12.** Pranë ISHMPUP në nivel qendror, krijohet “Komisioni i ankimit të ISHMPUP”. Komisioni i ankimit, drejtohet nga Kryeinspektori dhe ka në përbërje:
- a) një përfaqësues të njësisë që mbulon çështjet juridike;
  - b) një përfaqësues që mbulon çështjet e metodologjisë së inspektimit;
  - c) dy specialistë të tjerë të ISHMPUP në nivel qendror.
- 13.** Përbërja nominale e Komisionit të Ankimit, procedurat për shqyrtimin e ankimeve dhe vendimarrjen, miratohen me urdhër të Kryeinspektorit. Njoftimi dhe publikimi i Urdhërit bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.
- 14.** Komisioni i ankimit të ISHMPUP ushtron funksionet në përputhje me afatet dhe procedurat e ankimeve të parashikuara nga Ligji nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën

e Shqipërisë” i ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

15. Degët rajonale të ISHMPUP ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin në qarkun përkatës. Me urdhër të Kryeinspektorit, inspektorët e një dege rajonale mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në territorin e një qarku tjetër, në bashkëpunim me degën rajonale përkatëse.
16. Degët rajonale që kanë në territorin e tyre pika të kalimit të kufirit bashkëpunojnë me organet doganore dhe organet e tjera përkatëse për parandalimin e dëmtimit të cilësisë së mjedisit apo të përbërësve të tij të vecantë.
17. Degët rajonale të ISHMPUP drejtohen nga kryeinspektorët rajonalë. Kryeinspektori rajonal përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretet në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së degës së tij.
18. Në strukturën organizative të ISHMPUP në nivel qendror dhe në atë rajonal mbahen parasysh dhe ruhen profilet më të specializuara lidhur me inspektimin për mjedisin dhe ujërat, inspektimin mbi fondin pyjor dhe kullor dhe inspektimin e peshkimit. Punonjësit e policisë të shërbimit pyjor përfitojnë statusin e ushtarakut dhe barazohen me ligj me punonjësit e rendit publik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor.
19. Përveç sa parashikohet në paragrafin 16 të këtij vendimi, kryeinspektori rajonal:
  - a) lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;
  - b) vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin;
  - c) vendos për zëvendësimin e inspektorëve, gjatë inspektimit, sipas ligjit;
  - ç) shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët e degës përkatëse.
20. Kryeinspektori rajonal i raporton dhe i jep llogari drejtpërdrejtë Kryeinspektorit të ISHMPUP-së, përveçse kur Kryeinspektori ka përcaktuar shprehimisht, me urdhër, një njësi tjetër raportimi pranë ISHMPUP-së në nivel qendror.

#### **IV. STEMA DHE VULA ZYRTARE E ISHMPUP**

21. ISHMPUP identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

- 22.** Stema e ISHMPUP përbëhet nga Stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit”.
- 23.** Vula e ISHMPUP ka formën dhe elementet e përcaktuara në piken 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 390, datë 6.8.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare” i ndryshuar”. Vula e ISHMPUP në nivel qendror përmban dhe shënimin identifikues “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit”, ndërsa vulat e degëve rajonale përmbajnë dhe shënimin identifikues: “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit, Dega Rajonale e Qarkut (emri përkatës i qarkut)”.
- 24.** Vula e ISHMPUP dhe vulat e degëve rajonale, prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **V. DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT**

- 25.** Ngarkohet Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të marrë masat për :
- a) Paraqitjen e propozimit tek Kryeministri për emërimin e Kryeinspektorit të ISHMPUP;
  - b) Paraqitjen e propozimit tek Kryeministri për strukturën dhe organikën e ISHMPUP, sipas ligjit.
- 26.** Kryeinspektori i ISHMPUP, mbështetur nga njësitë përgjegjëse për shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe në përputhje me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve të miratuara nga Inspektorati Qendror, miraton kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMPUP.
- 27.** Nëpunësit që kryejnë funksionet e inspektimit të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij vendimi, që janë aktualisht të emëruar pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përfshirë institucionet e saj të varësisë apo drejtoritë e saj rajonale dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil si dhe kërkesat specifike të përcaktuara sipas paragrafit 24 të këtij vendimi, transferohen në detyra të reja pranë ISHMPUP, brenda numrit dhe pozicioneve të organikës të miratuar sipas Urdhërit përkatës të Kryeministrit.
- 28.** Verifikimi i plotësimin të kërkesave të përgjithshme dhe atyre specifike sipas paragrafit 24, dhe propozimi i transferimit për çdo nëpunës, kryhet nga një komitet ad hoc i krijuar posaçërisht për risistemimin e nëpunësve. Akti i transferimit, miratohet nga Kryeinspektori.
- 29.** Komiteti ad hoc sipas paragrafit 26 të këtij vendimi, përbehet nga dy përfaqësues të Departamentit të Administratës Publike, dy përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe

Administrimit të Ujërave, një përfaqësues nga Inspektorati Qendror dhe mbështetet në punën e tij nga njësia përgjegjëse për shërbimet mbështetëse në këtë ministri.

- 30.** Nëpunësit ekzistues të përcaktuar sipas paragrafit 25 të këtij vendimi, që nuk mund të transferohen në ISHMPUP, mbeten në institucionet përkatëse, të cilat riorganizohen brenda një periudhe 2 mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- 31.** Në cdo rast kryerja e procedurave sipas paragrafeve 24-28 do të kryhet duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
- 32.** Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përcakton edhe rishpërndarjen e mjediseve e mjeteve të punës si dhe merr masat e duhura për financimin me fonde buxhetore të ISHMPUP për vitin buxhetor 2013.
- 33.** ISHMPUP fillon punën sipas strukturës dhe funksionimit të përcaktuar në këtë vendim dhe aktet nënligjore në zbatim të tij më datë 1.1.2013. Deri më datën 31.12.2012 funksionet inspektuese vazhdojnë të kryhen nga strukturat aktuale.
- 34.** Çdo dispozitë apo akt nënligjor në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në datë \_\_\_\_\_, pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

.....